

Partnerët federalë na kanë sinjalizuar rishtazi rreth një numri të vogël ngjarjesh negative të rënda që kanë të bëjnë me vaksinën Johnson & Johnson (Janssen).

Megjithëse këto ngjarje duken të jenë tepër të rralla, kujdesi i tepërt na bëri që ta pezullojmë administrimin e vaksinës Johnson & Johnson në qytetin e Nju Jorkut, duke filluar që nga e marta (13 prill).

Rastet që po shqyrtohen nga FDA dhe CDC përfshijnë një loj koaguli gjaku që quhet tromboza venoze sinusale cerebrale (CVST), e cila është vëzhguar në kombinim me nivele të ulëta të pllakëzave të gjakut (trombocitopenia).

Personat që kanë marrë vaksinën J&J që kanë përjetuar dhimbje të forta të kokës, dhimbje barku, dhimbje këmbësh ose vështirësi në frymëmarrje brenda tre javësh pas vaksinimit, duhet të kontaktojnë ofruesin e tyre të kujdesit shëndetësor.

Mësoni më shumë rreth vaksinave të COVID-19:
nyc.gov/covidvaccine

Albanian

